



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1620, datë 22.06.2011

Për

“Shqyrtimin e ankimimit administrativ të Albtelcom sh.a në lidhje me Aktin Administrativ, Vendimi nr. 1565¹, datë 13.04.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelcom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU)”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 22.06.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e ankimimit administrativ të Albtelcom sh.a në lidhje me Aktin Administrativ, Vendimi nr. 1565, datë 13.04.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelcom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU)”,

¹ Albtelcom në Ankimin Administrativ i referohet aktit të ankimuar (“Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelcom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU)”) si Vendimi nr.1365, datë 13.04.2011. AKEP sqaron se referenca e saktë për këtë akt është: Vendimi nr.1565, datë 13.04.2011. Numri 1365 i Vendimit i pasqyruar në tekstin e Vendimit të publikuar dhe dokumentin e analizës ka qënë lapsus teknik dhe është korrigjuar tashmë nga AKEP.

BAZA LIGJORE:

1. Germa ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*K.Pr.A*);
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918 (*Rregullorja e Brendshme*);
4. “Rregullore për analizën e tregut”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 747, datë 17.07.2009 (*Rregullorja*);
5. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar (*Rregullorja*);
6. Vendimi 1565, datë 13.04.2011 i Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU)” (*Vendimi nr. 1565*),

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa nr. 2452 prot, datë 20.05.2011 e Albtelecom sh.a (AKEP nr. 704/3 prot, datë 23.05.2011) , (*Ankim Administrativë*);
2. Vendimi nr.1565, datë 13.04.2011 i Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU)” (*Vendimi nr. 1565*);
3. Projektvendim i KD të AKEP për Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a në lidhje me Aktin Administrativë, Vendimi nr. 1565, datë 13.04.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU)” (*Projektvendimi*);
5. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*);
si dhe, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Albtelecom me shkresën nr. 2452 prot, datë 20.05.2011 (AKEP nr. 704/3 prot, datë 23.05.2011) brënda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 140 te ligjit nr.8485, ka bërë

ankim administrativë për shfuqizimin e Aktit Administrativ Vendimi nr. 1565, datë 13.04.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU)”;

2. Albtelecom sh.a nëpërmjet Ankimit administrativë bazuar në nenin 138 të K.Pr.A kërkon pezullimin e zbatimit të Vendimit nr. 1565 dhe shfuqizimin e tij;
3. Albtelecom argumenton se, në zbatim të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, konsultimet publike për analizën e tregjeve dhe ai për përcaktimin e masave rregullatore duhet të zhvillohen njëri pas tjetri. Periudha 60 ditore për Albtelecom, i përket vetëm dokumentit të analizës për përmbajtjen e saj. Në përfundim të kësaj periudhe AKEP, publikon dokumentin final së bashku me komentet e palëve si dhe propozon masat rregullatore të cilat miratohen pas procesit të këshillimit publik të parashikuar në pikën 2 të nenin 36 të Ligjit nr. 9918, proces i cili kryhet në zbatim të nenit 110 të Ligjit nr. 9918;
4. Albtelecom thekson se, gjendet përballë vështirësive dhe pamundësive objektive për implementimin dhe realizimin e njëkohshëm të të gjitha detyrimeve të cilat bien ndesh me një nga parimet e kuadrit rregullator europian dhe të Ligjit nr. 9918, se vendosja e detyrimeve nuk duhet të jetë barrë e tepërt për operatorin;
5. Shkalla e zhvillimit dhe evoluimit të tregjeve është e tillë sa nuk justifikon analizimin e tyre dhe nuk mbështet përcaktime të sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg dhe as detyrimeve rregullatore të lidhura me to. Albtelecom konsideron se, është e nevojshme që tregjet të zhvillohen përmes nxitjes së investimeve të rëndësishme në infrastrukturën dhe shtimin e ofertës në nivel shumice dhe pakice. Albtelecom vlerëson se, këto tregje nuk janë të maturuara për analizimin e tyre dhe vendosjen e masave rregullatore propocionale;
6. Albtelecom thekson se, konkluzionet e paraqitura në dokumentin “Analizë e tregut me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU)”, mbi të cilat është bërë mes të tjerash edhe vlerësimi i fuqisë së ndjeshme, nuk mbështetet në të dhëna të sakta mbi shkallën e penetrimit në treg të sipërmarrësve ofrues dhe të teknologjive përkatëse të ofrimit të këtyre shërbimeve, duke refuar në dokument vetëm 36 nga 90 sipërmarrës të cilët kanë dërguar të dhëna në AKEP përmes plotësimit të formularit të kërkuar, si dhe mosverifikimi i saktësisë së të dhënave të kërkuara;
7. Albtelecom konsideron se, është nënvlerësuar si praktikë aksesi për shërbimet broadband, përdorimi në shkallë të gjërë i brezave *ISM* për të ofruar lidhje pikë në pikë si dhe *Wi-fi hot spot* kryesisht në zonat urbane të qyteteve;
8. Albtelecom vëren se, në analizat për tregjet e zhvilluara nga AKEP theksohet se me gjithë eliminimin e pengesave ligjore për hyrjen në treg ekzistojnë pengesa strukturore që lidhen me investimet në infrastrukturë që u duhen operatorëve alternativë për ofrimin e shërbimeve të caktuara të cilat merren në analizë, arsyetimi i cili është në kundërshtim me nenin 1 të Ligjit qëllimi i të cilit është promovimi i infrastrukturës eficiente dhe gërma dh) e pikës 3 të nenit 7, si dhe Rek. 2007, sipas të

- cilit AKEP nxit konkurrencën për të nxitur investimet efiçente në infrastrukturën e komunikimeve elektronike;
9. Albtelecom i konsideron të pa mbështetura konkluzionet e dokumentit lidhur me pengesat ligjore, ekonomitë e shkallës, ekonomitë e densitetit dhe integrimin vertikale, duke argumentuar se nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për sipërmarrësit e ofrimit të shërbimeve broadband;
 10. Albtelecom, pretendon se në dokumentin e Analizës së tregut vihet re mungesë konsistence dhe kohorence i kërkesave të pikës 2 të nenit 34 të Ligjit nr. 9918 lidhur me fuqinë e ndjeshme në treg;
 11. Albtelecom e konsideron të pa bazuar faktorin e praktikave të tjera rregullatore e cila justifikon me FNT operatorin incumbent, pasi operatorët incumbent të vendeve të tjera kanë trashëguar një infrastrukturë dhe nivele penetrimi të zhvillimi të rrjeteve përkatëse të cilat nuk mund të krahasohen me Shqipërinë;
 12. Për sa më sipër, Albtelecom nëpërmjet këtij ankimi administrativ kërkon shfuqizimin dhe pezullimin e zbatimit të aktit administrativ Vendimit nr. 1565, datë 13.04.2011 të AKEP, si dhe pranimin ankimit administrativ objekt ankimi sipas kërkesës së Albtelecom sh.a;
 13. AKEP, bazuar në shqyrtimin e pretendimeve të ankimit administrativë, në lidhje me Vendimin nr. 1565, datë 13.04.2011 të AKEP, gjykon se:
 - a. Në dokumentin e Analizës së Tregut të miratuar me Vendimin nr. 1565, datë 13.04.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumice të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU)”, AKEP ka dhënë sqarime dhe përgjigje për pretendimet e mësipërme të Albtelecom. Në Aneks 2 të dokumentit të cituar AKEP ka dhënë përgjigje për komentet e palëve të interesuara (përfshirë Albtelecom) duke dhënë sqarim për pretendimet e ngritura nga Albtelecom edhe në këtë ankim administrativ përfshirë:
 - i. Interpretimin e procedurës së konsultimit publik për analizën e tregut dhe masat rregullatore ku është sqaruar se, që në dokumentin e nxjerrë në konsultim publik AKEP ka vënë në dukje se konsultimi publik përfshinte analizën për FNT dhe masat rregullatore. Përcaktimet e Ligjit nr. 9918, detyrojnë AKEP që të konsultojë analizën për FNT dhe masat rregulluese, por nuk detyrojnë AKEP që të bëjë konsultime të veçanta për to: një për FNT dhe një për masat rregulluese. Kjo praktikë e ndjekur nga AKEP nuk është për herë të parë, pasi AKEP ka zhvilluar edhe analiza të tregjeve të tjerë si telefonia celulare, telefonia fikse dhe interkoneksioni;
 - ii. Zhvillimin e tregut broadband dhe argumentat pse ky treg nuk mund të quhet si treg i papjekur për rregullim, duke theksuar se dhënia e aksesit LLU është bërë me detyrim edhe për inkumbentët e vendeve të BE dhe në një kohë (duke filluar nga viti 2000) kur zhvillimi i aksesit broadband ishte ende i ulët edhe në BE;
 - iii. Të dhënat e përdorura për penetrimin e shërbimeve broadband;

- iv. Interpretimin pengesave ligjore, duke theksuar se AKEP nuk është shprehur se ekzistojnë pengesa ligjore (pasi ato janë eliminuar) por pengesa strukturore si ekonomitë e shkallës, dendësisë etj;
- v. Kriteret e përdoruar për përcaktimin e FNT të Albtelecom, duke sqaruar se AKEP ka marrë në konsideratë përcaktimet e nenit 34 si dhe të rekomandimeve përkatëse të KE, rekomandime të cilat theksojnë se kriteret për FNT nuk duhen parë të veçuara por në efektin total të tyre, si dhe disa kritere si p.sh. pjesa e tregut e lartë mbi 50% që përbëjnë shënja për FNT në treg;
- b. Në lidhje me komentin në pikën 8 më sipër të Albtelecom theksojmë se, AKEP me vendimin për dhënien akses në LLU nga Albtelecom, synon pikërisht nxitjen e investimeve efçente dhe kjo është theksuar edhe në impaktin rregullator. AKEP gjykon se mungesa e këtij detyrimi për Albtelecom ka çuar shpesh në investime të panevojshme nga Operatorët alternativë si ISP në linjat e aksesit tek përdoruesi fundor. AKEP ka marrë në konsideratë dhe ndryshimet në Shqipëri dhe në vendet e BE dhe kjo është cituar në dokumentin e Analizës finale në seksionin VI.2, dhe mbi bazën e gjithë analizës së kryer ka marrë vendimin për FNT të Albtelecom dhe masat rregulluese përkatëse, të cilat AKEP i gjykon të nevojshme për zhvillimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe rritjen e përfitimeve të konsumatorëve nga shërbime të komunikimeve elektronike, apo me specifikiisht aksesin broadband në internet. Gjithashtu masat rregulluese marrin në konsideratë investimet e kryera nga Albtelecom dhe tarifat e vendosura nuk janë nën-kosto por në kostot BULRAIC që nxisin investimet efçente si dhe i lejojnë Albtelecom një normë të arsyeshme fitimi. Tarifat e dhena në Vendimin nr.1565, datë 13.04.2011, do të jenë në fuqi deri në ndryshimin e tyre me një vendim tjetër të AKEP;
- c. AKEP vë në dukje përsëri se masat e vendosura ndaj Albtelecom janë të arsyeshme dhe nuk përbëjnë barrë rregullatore. Kujtojmë se detyrimet e vendosura për LLU në vendet anëtare të BE kanë filluar të aplikohen që në vitin 2000,

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S :

1. Të rrëzojë kërkesën ankimore nr. 2452 prot, datë 20.05.2011 të Albtelecom sh.a. në lidhje me Vendimin nr.1565, datë 13.04.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP;
2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 1565, datë 13.04.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU)”;

3. Të njoftohet sipërmarrësi Albtelecom sh.a për zbatimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**